

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arhiva - Archive

Nr. i llogaritjes: 02/Punë ligjore
Org. Jedin: 2090-59/2023
Org. Unit: 2-1
Nr. i faqeve: 1
Broj. stranica: 1
No. pages: 1
Data: 18.10.2023
Datum: 18.10.2023
Date: 18.10.2023
Dafëse: PRISHTINË/A



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers

Për:	Ramiz Lladrovci , Kryetar i Komunës së Glllogocit
Kopje:	Milaim Hajdari , Kryesues i Kuvendit të Komunës Elbert Krasniqi , Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Jeton Qela , Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes:	Resul Makreshi , Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve Enis Spahiu , Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Nga:	Bora Duli , Zv. Drejtoreshë e Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Zyrtarët përgjegjës:	Razije Murtezaj , Zyrtares Ligjore, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve Kimete Zekaj , Zyrtares e Lartë për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë të aktit të Komunës së Glllogocit
Lloji i aktit:	Vendim



I nderuari Kryetar z. Lladrovci,
I nderuari Kryesues z. Hajdari,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

<i>Vendim Nr. 400-48424 për rialokimin e mjeteve financiare</i>
<i>I miratuar më datë 27.09.2023</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 28.09.2023</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 02.10.2023</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si “Ministria”), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Glllogocit, jep konstatimet e mëposhtme:

1. Me anë të aktit administrativ të Komunës së Glllogocit që është subjekt i shqyrtimit, synon rialokimin e mjeteve financiare brenda nën-programeve buxhetore në kategorinë e shpenzimeve kapitale.
2. Për qëllime të këtij vlerësimi, është relevante të theksohet se procesi i ndryshimeve në shumat e ndara për projektet kapitale në kuadër të nën-programeve evidentohet edhe në legjislacionin që bie në fushëveprimin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, si por duke mos u kufizuar në dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 (këtej e tutje referuar si ‘Ligji i Buxhetit 2023’), Udhëzimet Administrative Nr.04.2029 për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2019 për Kriteret Përzgjedhëse dhe Prioritizimin e Projekteve Kapitale (këtej e tutje referuar si ‘Udhëzimet Administrative’).
3. Në kuptim të ndryshimeve në shumat e ndara buxhetore, neni 16, paragrafi 11 i Ligjit të Buxhetit 2023 përcakton se Komunitat mund të transferojnë dhe/ose alokojnë mjetet nga projektet kapitale, si në vijim:

Neni 16

Ndryshimet në shumat e ndara për projektet kapitale në kuadër të nën-programeve



11. Ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet ekzistuese si rezultat i transfereve dhe/ose rialokimeve, të prezantuara në tabelën 4.2., duke përfshirë edhe të hyrat vetanake të barta, si dhe të regjistruara në SIMFK, duhet të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal, kurse në rastin e FZHM-së ndryshimet në shumat e ndara buxhetore duhet të aprovohen nga Bordi i FZHM-së. Ndryshimet e bëra të parapara me këtë nën regjistrohen në SIMFK nga Ministri.

4. Nisur mbi premisat e këtij argumentimi, mbetet evidente se organizata buxhetore ka bërë ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e projekteve, Përkundër kësaj, realizimi i suksesshëm i një procesi të tillë karakterizohet me detaje teknike buxhetore për të cilat organizatat buxhetore të bashkëpunojnë ngushtë me Departamentin e Buxhetit.
5. Në këtë kuptim, Ministria konstaton se ligjërisht, Komunave iu mundësohet marrje e vendime të tilla, mirëpo realizimi i suksesshëm i tyre **kushtëzohet** me përputhshmërinë e materialeve përcjellëse të lëndëve të proceduara nga Komuna në raport me udhëzimet dhe/apo rekomandimet e Departamentit të Buxhetit lidhur me Udhëzimet Administrative dhe të ngjashme. Kjo nënkupton se vendimet e organizatave buxhetore mund të pësojnë ndryshime, konform rekomandimeve teknike të dhëna nga Departamenti i Buxhetit në Ministri.
6. Në këtë kuptim, Ministria konstaton se **akti administrative i Komunës së Glllogocit është në përputhje me legjislacionin në fuqi** - mirëpo realizimi i suksesshëm **kushtëzohet** me përputhshmërinë e materialeve përcjellëse të lëndëve të proceduara nga Komuna në raport me udhëzimet dhe/apo rekomandimet e Departamentit të Buxhetit. Kjo nënkupton se vendimet e organizatave buxhetore mund të pësojnë ndryshime, konform rekomandimeve teknike të dhëna nga Departamenti i Buxhetit në Ministri.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Glllogocit dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministristwo Administracji Lokalnej Samouprawy
Ministry of Local Government Administration

Për:	Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve
Kopje:	Kryetar i Komunës së Glogocit Kryesuesi i KK - Glogoc Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Jeton Qela, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL
Nga:	Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Ministri të Linjës 2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse
Lënda:	Shkresë përcjellëse në MFPT
Lloji i aktit:	Vendim

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar: Vendimin Nr. 400-48424 për rialokimin e mjeteve financiare, i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Glogocit, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 3, të Rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendimin Nr. 400-48424 për rialokimin e mjeteve financiare

I miratuar më datë: 27.09.2023

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 28.09.2023



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Glllogoc)
Kuvendi i Komunës
Nr. 400-47 62 Ldt. 27.09.2023



Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 16, pika 11 të Ligjit Nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 27.09.2023, miratoi këtë:

VENDIM

Neni 1

Miratohet riallokimi i mjeteve financiare brenda nënprogramit Infrastruktura Publike (14161) dhe kategorisë së Shpenzimeve Kapitale (30) në shumën 70,000.00 euro si dhe nënprogramit Shëndetësi Primare (73100) dhe kategorisë së Shpenzimeve Kapitale (30) në shumën 4,621.00 euro.

Neni 2

Riallokimi i mjeteve bëhet nga projektin "Ndërtimi i rrugës bregut të Qigavices", kodi 52309, nga burimi i fondeve Grande Qeveritare (10) në shumën 70,000.00 euro në projektet:
"Asfaltimi i rrugës në fshatin Arllat, Negroç, Gjergjiçë si dhe Bytyq" (48646) në shumën prej 14,850.25€
"Asfaltimi i rrugës në fshatin Zabel i Ulët dhe i Epër, Korroticë e Ulët dhe e Epërme" (48658) në shumën prej 35,946.70€,
"Asfaltimi i rrugës në fshatin Pöklek i Vjetër, Pöklek i Ri dhe Vasilevë" (48615) në shumën prej 19,203.05


Riallokimi i mjeteve bëhet nga projektin "Rrëthojat në QMF, AMF Komoran, Arllat, Nekoc, Terdec dhe Gllanasellë", kodi 53709, nga burimi i fondeve Grande Qeveritare (10) në shumën 4,621.00€ në projektin "Pjerrinat në AMF, Arllat, Gllanasellë, Nekoc dhe Abri" (53721)

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Web faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë Përkatese;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Arsyetim

Mjetet e planifikuara ne projektin "Ndërtimi i rrugës bregut te Qiqavices" janë planifikuar për të ruajtur kodin buxhefor dhe për të kërkuar mbështetje financiare nga ministrit mirëpo nuk janë të mjaftueshme për zhvillimin e punimeve në teren gjatë këtij viti.

Në këto kode të cilat duhet të plotësohet masa buxhetore, janë punë të kontraktuar dhe të përfunduara në teren të cilat duhet të mbyllen brenda vitit 2023.

Projekti i Shërbimeve Primare Shëndetësore është shpallur në dy kode në një kontratë ku oferta e operatorit ekonomik më të lirë ka ardhur më e ulët se planifikimi në projekt buxhet ne rrethoja ndersa në pjerrina ka ardhur oferta me e lartë se planifikimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
KOMUNA E DRENASIT
Zyra e Kryetarit



Nr. 01-400-47433 Dt. 20.02.2023

Në bazë të nenit 58, paragrafi 1, pika (b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040; Nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 16, pika 11 të Ligjit Nr.08/L-198 mbi ndarjen buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, Kryetari i Komunës së Drenasit propozon që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të rregullt të aprovoj:

PROPOZIM - VENDIM

Neni 1

Propozohet riallokimi i mjeteve financiare brenda nënprogramit Infrastruktura Publike (18161) dhe kategorisë së Shpenzimeve Kapitale (30) në shumën 70,000.00 euro si dhe nënprogramit Shëndetësi Primare (73100) dhe kategorisë së Shpenzimeve Kapitale (30) në shumën 4,621.00 euro.

Neni 2

Riallokimi i mjeteve bëhet nga projekti "Ndërtimi i rrugës bregut të Qiqavices", kodit 52309, nga burimi i fondeve Grande Qeveritare (10) në shumën 70,000.00 euro në projektet:
"Asfaltimi i rrugës në fshatin Arllat, Negroç, Gjergjicë si dhe Bytyq" (48646) në shumën prej 14,850.25€
"Asfaltimi i rrugës në fshatin Zabel i Ulët dhe i Epërm, Korroticë e Ulët dhe e Epërme" (48658) në shumën prej 35,946.70€
"Asfaltimi i rrugës në fshatin Poklek i Vjetër, Poklek i Ri dhe Vasilevë" (48635) në shumën prej 19,203.05

Riallokimi i mjeteve bëhet nga projekti "Rrethojat në QMF, AMF Komorian, Arllat, Nekoc, Terdec dhe Gllanasellë", kodit 53709, nga burimi i fondeve Grande Qeveritare (10) në shumën 4,621.00€ në projektin "Pjerrinat në AMF, Arllat, Gllanasellë, Nekoc dhe Abrë" (53721)

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtorja e Infrastrukturës Publike

KRYETARI I KOMUNËS

Ramir Eladrovci

Arsyetim

Mjetet e planifikuara në projektin "Ndërtimi i rrugës bregut të Qiqavices" janë planifikuar për të ruajtur kodin buxhetor dhe për të kërkuar mbështetje financiare nga ministrit mirëpo nuk janë të mjaftueshme për zhvillimin e punimeve në teren gjatë këtij viti.

Në këto koda të cilat duhet të plotësohet masa buxhetore, janë punë të kontraktuar dhe të përfunduara në teren të cilat duhet të mbyllet brenda vitit 2023.

Projekti i Shërbimeve Primare Shëndetësore është shpallur në dy kode në një kontratë ku oferta e operatorit ekonomik më të lirë ka ardhur më e ulët se planifikimi në projekt buxhet në rrethoja ndërsa në pjesën ka ardhur oferta më e lartë se planifikimi.